

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"RREZI COM" SHPK

Sot, më datë 15/08/2022, u paraqiten personalisht:

- **Z. Ismet Murtezaj**, i datëlindjes 01/08/1965, shtetas Kosovar, lindur ne Kline e Poshtme, Skenderaj, Kosove dhe banues ne adrese Rruga "Agron Rrahmani, Nr. 12, Bresje, Fushe-Kosove, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i pasaportes me nr P02114738 dhe Nr. Personal 1173348785.

I cili përpiloi këte akt themelimi të shoqërisë tregtare "RREZI COM" SH.P.K, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Forma Ligjore

Të themeloj Shoqërinë Tregtare "RREZI COM" SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "RREZI COM" SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit "RREZI COM" SH.P.K dhe me emrin tregtar **RREZI COM**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

- Agjensi imobiliare.
- Angazhim ne blerje, shitje, marrje dhe dhenie me qira te cdo lloj pasurie te patundshme.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në Lezhë, në adresën: Tale, Truall me Nr. Pas. 11/1, Z.K. 1879, Lezhë.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar është Lekë 100.000 (njqind mije leke) dhe zotërohet nga ortakët themelues:

Vlera totale e kapitalit të regjistruar: Lekë 100.000 (njqind mije leke)

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1.

Kapitali themeltar është mbuluar tërësisht nga ortakët themelues.

NENI 7

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare "RREZI COM" SH.P.K zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Ortaku themelues :	Ismet Murtezaj
Numri i kuotave :	1
Numri i pjeseve :	1
Pjesëmarrja në Shoqëri :	100,00 %
Lloji i kontributit:	Ne para
Vlera e kontributit	100,000 (njqind mije) leke

Duke qenë se Kapitali themeltar do të depozitohet në llogarinë e Shoqërisë e cila do të hapet pas regjistrimit në QKB, atëherë ortakët vendos që kjo shume do të paguhet prej tij jo më vonë 3 muaj nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, në llogarinë e shoqërisë tregtare. Rregullat e pagesës së kesaj shume janë parashikuar në këtë Statut.

NENI 8

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 9

Administratori/ët

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit/ëve të cilët zgjidhen për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqërisë do të jetë :

- **Z. Ismet Murtezaj**, i datëlindjes 01/08/1965, shtetas Kosovar, lindur në Kline e Poshtme, Skenderaj, Kosovë dhe banues në adresë Rruga "Agron Rrahmani, Nr. 12, Bresje, Fushe-

Kosove, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i pasaportes me nr P02114738 dhe Nr. Personal 1173348785.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

NENI 12

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues, u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe, duke qene se ortaku eshte njohes i gjuhes shqipe.

ORTAKU THEMELUES

Ismet Murtezaj

